

KOMENTARI

I

**KODIT TË ETIKËS PËR PROKURORIN E
SHTETIT**

I.PJESA E PARË.....	3
1.Përmbledhje ekzekutive.....	3
i. Hyrje	3
ii. Qëllimi i Komentarit të Kodit të Etikës.....	4
iii. Fushëveprimi.....	4
I. PJESA E DYTË.....	5
1. Parimet e përgjithshme	5
i. Pavarësia	5
Të nesërmen, në zyrën e prokurorit, paraqitet kryeprokurori, i cili ia ofron dy bileta për një ndeshje futbollit për pranimin e telefonatës nga ana e anëtarit të Kuvendit.	7
- A duhet që prokurori të pranojë sugjerimin e kryeprokurorit për t'iu përgjigjur telefonatës? 7	
- A duhet që prokurori të pranojë telefonatën nga anëtari i Kuvendit?	7
- A duhet që prokurori të pranojë biletat për ndeshjen e futbollit?	7
- Si duhet të veprojë prokurori në këtë situatë?	7
ii. Paanshmëria.....	8
iii. Integriteti	11
iv. Konfidencialiteti	17
v. Llogaridhënia dhe transparenca.....	16
vi. Profesionalizmi	23

I. PJESA E PARË

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

i. Hyrje

Sistemi prokurorial me integritet të pacenuar është bazë për sigurimin e respektimit të demokracisë dhe sundimit të së drejtës.

Prokurorët ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.¹

Kodi i Etikës dhe i Sjelljes Profesionale për Prokurorë promovon integritetin e sistemit prokurorial.




Pas miratimit të Kodit të ri të Etikës është vlerësuar e nevojshme që ky kod të shoqërohet për herë të parë edhe me një komentari udhëzues, përmes të cilit do t'u jepen sqarime prokurorëve për dilemat e ndryshme etike, me të cilat mund të ballafaqohen gjatë karrierës së tyre si prokurorë.

Komentari i Kodit të Etikës jep shpjegime për vlerat thelbësore të etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve dhe parimet e përcaktuara në këtë dokument të rëndësishëm të etikës.

Përveç kësaj, ky komentari, përmes shembujve të ndryshëm hipotetikë dhe ngritjes së pyetjeve dilemore, përshkruan edhe rrethana dhe situata nga më të ndryshmet, me të cilat mund të ballafaqohen prokurorët.

Këta shembuj dhe përgjigjet që përmbajnë për situatat e ndryshme do t'iu ndihmojnë prokurorëve për të vepruar në mënyrë të drejtë dhe të ndershme.

Komentari i Kodit të Etikës, përmes shembujve të dhënë, sqaron disa nga situatat e parapara në parimet e kodit, siç janë:

-  Pavarësia,
-  Paanshmëria,
-  Integriteti,

¹ Shih udhëzimet evropiane për etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë me titull: "Udhëzimet e Budapestit", të miratuara më 31 maj 2005.

- ✚ Llogaridhënia,
- ✚ Transparenca dhe
- ✚ Profesionalizmi.

Ky komentari në vazhdimësi do të plotësohet me shembuj të tjerë praktikë të cilët dalin nga jeta dhe puna e përditshme e prokurorëve.

ii. Qëllimi i Komentarit të Kodit të Etikës

Qëllimi i Komentarit të Kodit të Etikës për prokurorë është përcaktimi dhe shtjellimi i rregullave, parimeve dhe udhëzimeve për sjelljen e prokurorëve për të siguruar ushtrimin e funksioneve të tyre në mënyrë të pavarur, me paanshmëri, integritet, llogaridhënie, transparencë dhe profesionalizëm.

iii. Fushëveprimi

Fushëveprimi i Komentarit, në përputhshmëri me Kodin e Etikës, shërben si udhërrëfyes i pasuruar me shembuj konkretë për prokurorët dhe sjelljet e tyre për punën zyrtare dhe sferën private të jetës së tyre.

I. PJESA E DYTË

1. PARIMET E PËRGJITHSHME

i. Pavarësia

Çdo shtet demokratik duhet ta ketë të theksuar ndarjen e pushteteve përmes aktit më të lartë juridik të atij vendi. Prokurori i Shtetit është i pavarur nga pushtetet e tjera. Prokurori është ai që i jep impuls çdo procedure penale dhe mbetet i përfshirë deri në përfundimin e saj.

Pavarësia personale e prokurorit si individ nënkupton lirinë e tij për të vendosur pa u ndikuar nga askush, përfshirë kolegët, shoqërinë, familjarët, rrethet politike dhe vetë eprorin e tij.

Në kryerjen e funksionit të tij, prokurori ka një shkallë të lartë pavarësie dhe vendimet e tija duhet t'i marrë në bazë të rrethanave të çështjes, duke u bazuar në ligj, në prova dhe në ndërgjegjen e tij.

Pavarësia personale ka të bëjë edhe me refuzimin e ndikimeve të ndryshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të cilat mund të vijnë nga kushdo, brenda dhe jashtë institucionit.

Prokurorët, duke përjashtuar diskutimet e mirëfillta dhe parimore, apo udhëzimet e detyrueshme që jepen sipas ligjit, duhet t'i përmbahen detyrimit që të mos të ndikojnë te kolegët e tyre në asnjë formë.

Kjo duhet të bëhet, ngaqë është shumë i rëndësishëm perceptimi i publikut për pavarësinë e prokurorëve. Prandaj, prokurorët duhet të jenë tejet vigjilentë, në mënyrë që të mos zbehet besimi i publikut në pavarësinë e tyre.

Shembulli 1: Prokurori X ka një rast vrasjeje ende të pazgjidhur. Atij i telefonon kolegu i tij, prokurori Y, duke i thënë se është mik i afërt i babait të të pandehurit në rastin e vrasjes që i është caktuar atij. I kërkon që të kujdeset që djali të ketë një hetim të drejtë. Gjithashtu i thotë se nuk beson se dikush nga ajo familje mund të ketë kryer vrasjen.

- A është e drejtë sjellja e prokurorit Y?
- A ka të drejtë kolegu tjetër që të kërkojë trajtimin e drejtë të një të pandehuri?
- A paraqet kjo përpjekje për të ndikuar në rastet e një prokurori tjetër?
- Çka nëse prokurori Y me të vërtetë beson se ai nuk e ka kryer vrasjen?
- A është e drejtë nëse prokurori X e pranon sugjerimin e prokurorit Y?

Komentim:

Çdo prokuror e ka të ndaluar të ndërmarrë veprime, me të cilat do ta influencojë vendimmarrjen e kolegëve të tjerë prokurorë, si dhe me këtë edhe ta cenojë pavarësinë e tyre. Pavarësia në vendimmarrje duhet të respektohet nga të gjithë dhe të jetë i lirë nga çdo ndikim i jashtëm apo që vjen brenda institucionit. Prokurorët mund t'i diskutojnë rastet që i kanë në punë vetëm në parim, sa i përket dilemave në aplikimin e ligjit, pa i identifikuar se cilat janë ato dhe kundër kujt zhvillohen.

Shembulli 2: Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë planifikon që t'i blejë së bijës një veturë. Meqë nuk i ka të gjitha paratë, prokurori shkon në bankën në të cilën shkon rregullisht dhe kërkon të dijë për kushtet për të marrë një kredi hipotekare. Nëpunësi i bankës, i ngarkuar me çështjet e kredive, i thotë: “Meqë ju jeni prokuror, banka do t’ju ofrojë kushte më të volitshme në krahasim me ato që ju ofron klientëve të tjerë të zakonshëm. Do t’u jepet shumë më e madhe e kredisë për një kamatë më të vogël.”

- A duhet ta pranojë prokurori fare këtë ofertë?
- A duhet ta pranojë po qe se ajo bankë nuk ndodhet nën juridiksionin ku punon prokurori?
- A mund ta shfrytëzojë prokurori postin e tij për përfitime personale?
- A ka rrezik që me pranimin e ofertës ta rrezikojë pavarësinë e tij personale në vendimmarrjen e ardhshme si prokuror?

Komentim:

Në asnjë rast prokurori nuk do të pajtohet të përfitojë favore dhe përfitime të tjera personale jashtë rregullave të miratuara bankare, duke shfrytëzuar pozitën e tij si prokuror. Në rastin konkret prokurori duhet ta refuzojë ofertën dhe të heqë dorë nga kërkesa për kredi në atë bankë. Kjo mënyrë e sjelljes mund ta rrezikojë pavarësinë e prokurorit në punën e tij në raste të ndryshme.

Shembulli 3: Kryeprokurori X paralajmëron prokurorin Y për një telefonatë, të cilën ky i fundit do ta pranojë më vonë gjatë ditës. Prokurori Y, pas disa orësh, pranon një telefonatë nga anëtar i Kuvendit Z, i cili i thotë: “Ju jeni prokuror rasti në një përleshje në një lokal nate. Shikoni, në atë rast është i përfshirë nipi im. E dini, ai djalë është ngatërruar pa dashje në atë lokal, i shtyrë nga disa miq të tij dhe është hera e parë që përfshihet në një ngatërresë të tillë. Ju lutem të keni një konsideratë për këtë rast dhe të mos e paraqitni, kurse unë ju premtoj që nipi im nuk do përfshihet më në këso lloje ngatërresash.”

Të nesërmen, në zyrën e prokurorit, paraqitet kryeprokurori, i cili i ofron dy bileta për një ndeshje futbolli për pranimin e telefonatës nga ana e anëtarit të Kuvendit.

- A duhet që prokurori të pranojë sugjerimin e kryeprokurorit për t'iu përgjigjur telefonatës?
- A duhet që prokurori të pranojë telefonatën nga anëtari i Kuvendit?
- A duhet që prokurori të pranojë biletat për ndeshjen e futbollit?
- Si duhet të veprojë prokurori në këtë situatë?

Komentim:

Prokurori duhet të jetë i pavarur nga të gjitha ndikimet e brendshme dhe të jashtme dhe t'i trajtojë palët pa asnjë diskriminim dhe këtë duhet ta tregojë me çdo veprim të tij. Në rastin konkret prokurori nuk duhet të pranojë sugjerimin e Kryeprokurorit për t'iu përgjigjur telefonatës dhe as që të pranojë telefonatën e sugjeruar. Gjithashtu, në këtë rast, kryeprokurori/prokurori nuk duhet në asnjë formë të pranojë dhuratën. Në këtë rast ai duhet të vazhdojë procedurën e filluar dhe të veprojë sipas ligjit dhe provave të rastit. Veprimet e kryeprokurorit drejtuar prokurorit të rastit nuk janë në përputhje me parimin e pavarësisë së prokurorëve dhe kodin e etikës. Veprimet e kryeprokurorit në rastin konkret dëmtojnë rëndë reputacionin e vetë kryeprokurorit, prokurorit dhe sistemit prokurorial në tërësi.

Shembulli 4: Prokurori X derisa ishte kujdestar, në kuadër të kompetencave të tij ka ndaluar një person të dyshuar për 48 orë me dyshimin se ka kryer një vepër penale. Derisa prokurori ishte duke e vlerësuar rastin për të vendosur nëse është e nevojshme të bëjë kërkesë për ndonjë masë për sigurimin e prezencës së të dyshuarit në procedurë penale, ai ka pranuar një telefonatë nga një zyrtar që punon në sistemin prokurorial. Ky zyrtar gjatë bisedës në telefon ka njoftuar prokurorin se personin që ka ndaluar është djali i dajës së tij dhe, njëkohësisht, ka sugjeruar prokurorin që ta ketë parasysh këtë fakt dhe ta bëjë një vlerësim të mirë të rastit, natyrisht, në favor të të dyshuarit. Prokurori vihet në dilemë se si të veprojë me rastin pas kësaj situatë të krijuar: Të bëjë kërkesë për ndonjë masë për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale, edhe pse nuk plotësohet kushti i dyshimit të bazuar, ndërsa po ta lironte të dyshuarin në procedurë të rregullt pas telefonatës së pranuar, do të krijohej bindja se prokurori ishte ndikuar nga kolegu i tij.

- Si të veprojë prokurori?
- Të bëjë kërkesë për caktimin e masës për sigurim të të dyshuarit në procedurë penale?
- Ta lirojë të dyshuarin, sepse nuk janë siguruar prova për vërtetimin e dyshimit të bazuar?

Komentim:

Në një situatë të tillë, prokurori duhet të jetë i kujdesshëm që të mos e vë në pikëpyetje pavarësinë e tij/saj në vendosjen e rastit. I gjendur para një situatë të tillë, më e mira do të ishte që prokurori ta njoftonte menjëherë kryeprokurorin e tij përmes një shënimi zyrtar, i cili duhet të ndërmarrë veprime ligjore ndaj zyrtarit që ka telefonuar prokurorin. Në secilin rast, prokurori duhet ta ruajë pavarësinë e tij në vendimmarrje nga çdo ndikim i jashtëm apo i brendshëm dhe vendimet i merr vetëm në bazë të ligjit, vlerësimit të drejtë të fakteve dhe provave dhe që përpjekjet për ndikime t'i drejtojnë te eprori i tij, në atë mënyrë që të eliminohet perceptimi i ndikimit në pavarësinë e prokurorëve.

ii. Paanshmëria

Paanshmëria është njëra ndër vlerat më të rëndësishme që duhet ta cilësojë punën e prokurorit. Është e rëndësishme që paanshmëria jo vetëm të ekzistojë, por edhe të perceptohet që ekziston nga çdo vëzhgues i jashtëm.

Mungesa e paanshmërisë, ose vetëm një perceptim negativ për njëanshmëri, ka gjasa që të krijojë një ide padrejtësie, gjë që në një afat më të gjatë do të dëmtojë besimin e publikut në tërë sistemin prokurorial.

Gjithmonë, sikurse te ekzistimi i pavarësisë, po ashtu edhe paanshmërisë, për të arritur deri te një përfundim i drejtë duhet zbatuar standardi i vëzhguesit objektiv, andaj duhet shtruar pyetja: A mundet një vëzhgues i arsyeshëm, i cili ka një vështrim realist të situatës dhe nuk ka interesa të drejtpërdrejta, të vije në përfundim se një prokuror është i paanshëm!?

Perceptimi se një prokuror nuk është i paanshëm mund të vije si rezultat i shumë faktorëve, si: dyshimet për konflikt interesi, sjelljet e prokurorit, veprimtaria jashtë punës si prokuror, interesat financiare të tij ose anëtarëve të familjes, njohjet e ndryshme personale, deklaratat publike, si dhe rrethanat e situatat e tjera.

Dukja e paanshmërisë gjithmonë mund të jetë problem dhe çdo prokuror, si në zyrën e tij po ashtu edhe në sallën e gjykatës, duhet të sillet me kujdes duke respektuar të gjithë pjesëmarrësit, duke i dëgjuar të gjithë pjesëmarrësit me durim, ashtu siç e parasheh ligji dhe duke i ikur manifestimit të paragjyqimeve.

Pozita e të gjitha palëve në një çështje është shumë e ndjeshme dhe për shkak të asaj pozite janë të prirë që të shohin prokurorin me paragjykim dhe njëanshmëri, edhe kur ai me të vërtetë është i drejtë dhe i paanshëm. Prandaj, prokurori duhet të bëjë të gjitha përpjekjet që të parandalojë lindjen e dyshimeve për njëanshmëri.

Rastet kur familjarët dhe të afërmit e prokurorëve merren me punë dhe aktivitete të ndryshme politike mund të ndikojnë në perceptimin e publikut në paanshmëri të tyre.

Edhe jashtë zyrës, prokurori duhet të shmangë përdorimin e fjalëve ose sjelljeve që shkaktojnë lindjen e dyshimeve për mungesë paanësie. Të përmbahet nga komentimet e rasteve të ndryshme që janë në procedurë dhe të jetë i vëmendshëm që të mos të lejojë që me sjelljet e tij të zgjojë çfarëdo dyshimesh në publik për mungesë paanësie.

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës rregullon procedurën në bazë të së cilës një prokuror bën kërkesë për përjashtimin e tij nga një rast ose kur palët e kërkojnë këtë.

Shembulli 1: Prokurori GG është nga Prizreni, aty ka lindur dhe ka kryer shkollimin. Prokurori GG gjatë jetës së tij shpesh ka bërë deklarata nëpër kafene dhe gjetiu, duke mos treguar respekt për njerëzit që vijnë nga fshatrat përreth ose që kanë prejardhje fshati.

Tani ai punon si prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren. Edhe si prokuror nuk e fsheh këtë edhe nëpër rrethet private. Ndërkohë, në punën e tij si prokuror merr një rast kundër një të dyshuari, një blektor, i cili vinte nga një fshat i largët, që gjendej në lartësitë e bjeshkëve.

Duke qenë se prokurori njihej si përçmues i fshatarëve, edhe i dyshuari e kishte dëgjuar këtë qëndrim të prokurorit, kërkon përjashtimin e tij me këtë arsyetim.

- Si të vlerësohet qëndrimi i tij publik lidhur me njerëz me prejardhje gjeografike të caktuar?
- Si duhet të veprojë kryeprokurori në këtë rast?
- A janë qëndrimet e tij paragjyquese, diskriminuese dhe a përbëjnë rrezik për mungesë paanësie?
- Si duhen të sillen prokurorët në publik për të rritur besimin e publikut?

Komentim:

Çdo sjellje e prokurorit në publik duhet të jetë e cilësuar dhe e përcjellë me standarde të larta të integritetit. Prokurori nuk guxon të shprehë paragjykime për persona me prejardhje të ndryshme etnike, fetare, gjinore, gjeografike apo çfarëdo cilësie tjetër, sepse kjo paraqet rrezik për anim, apo së paku, për perceptimin e paanësisë së tij. Të gjitha palët duhet t'i trajtojë me respekt, ndershmëri dhe pa asnjë lloj diskriminimi dhe paragjykimi.

Shembulli 2: Bashkëshorti i Prokurores D është zëvendëskryetar i një partie politike me influencë të madhe. Një ditë organizohet një pritje në hapësirat e Hotelit “Z” në Prishtinë, me ç’rast ftohen figura të ndryshme publike dhe politike, të gjithë me bashkëshort-e. Prokurorja D e shoqëron burrin e saj politikan në këtë pritje dhe aty takon shumë persona të tjerë që merren me politikë.

- A është ky veprim i drejtë i Prokurores D shkuarja në këtë ndejë?
- Cilat janë dilemat etike në këtë situatë, argumentet për dhe kundër shkuarjes së saj?
- A duhet të izolohehen prokurorët tërësisht nga jeta shoqërore dhe familjare?

Komentim:

Prokurorëve nuk u kërkohet që të izoloohen tërësisht nga jeta sociale. Bërja e një jete tejet të kufizuar dhe pa kontakte shoqërore ka ndikim edhe në vendimmarrjen e prokurorëve, sepse shkëputja nga realiteti shoqëror mund të sjellë deri te mungesa e cilësisë në punë dhe në vendimet që i merr. Megjithatë, prokurori kur del në publik dhe kur shoqërohet me të tjerë, duhet të jetë i vëmendshëm që të mos krijojë perceptim të mungesës së pavarësisë dhe paanshmërisë. Në shembullin e mësipërm, ndeja është publike, prokurorja shoqëron bashkëshortin e saj, prandaj apriori nuk duhet ndaluar këto, mirëpo nëse paraqitet ndonjë rast që prokurorja duhet ta trajtojë kundër zyrtarëve të atyre rretheve, ajo duhet menjëherë të kërkojë përjashtimin e saj.

Shembulli 3: Prokurori është i ngarkuar me një rast, ku i akuzuari është i përkatësisë etnike X, ndërsa i dëmtuari i përkatësisë etnike Y. Prokurori është i përkatësisë X dhe ka disa anëtarë të familjes së zhdukur si pasojë e luftës së fundit, të cilën e kanë zhvilluar pjesëtarët e përkatësisë etnike Y.

- A duhet prokurori të ndërmarrë veprime në këtë rast?
- Si duhet të veprojë prokurori në këtë rast?

Komentim:

Secili prokuror duhet të kujdeset që në rastet e tilla kur ai nuk e ndjen veten se mund të jetë objektiv ose për t'i ikur perceptimit dhe dyshimit të mundshëm për njëanshmëri nga palët në procedurë duhet të kërkojë përjashtimin e tij nga rasti.

Shembulli 4: Prokurori E është punësuar në Prokurorinë Themelore në Prizren. Ndërkohë, në Prizren e ushtron profesionin si avokat edhe z.G. Të dy janë të një gjenerate, janë shkolluar bashkë dhe hapat e parë në profesionin e drejtësisë i kanë bërë bashkërisht në ish-Gjykatën Komunale në Prizren.

Avokati B ka shumë punë, mbron shumë të pandehur pikërisht në atë gjykatë në fazën e hetimeve dhe në fazën e gjyqimit. Gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, por edhe në seancat hetimore, raportet e tyre janë shumë profesionale dhe asgjë nuk zgjon dyshime për paanësi të prokurorit.

Përkundrazi, ka pasur disa raste që prokurori, gjatë marrjes në pyetje të të pandehurve që i mbronte avokati, për shkak se ka ndërhyrë me pyetje pa radhë dhe pa iu lejuar pyetja, avokati është larguar nga salla.

Mirëpo ata të dytë çdo mbrëmje dalin së bashku dhe takohen në qendër të Prizrenit dhe vazhdojnë së bashkë duke ecur deri te “Marashi”, ku pasi pinë nga një kafe, kthehen këmbë nëpër shtëpitë e tyre. Këtë rutinë e përsërisin çdo mbrëmje.

- A duhet prokurori të rrijë bashkë me një avokat, edhe kur kanë shumë lëndë së bashku?

- A duhet ndaluar prokurorëve që të kenë marrëdhënie shoqërore me avokatët?
- Kush duhet të jetë ai që do të vendosë se deri ku do të shkojë kjo miqësi?
- Kjo miqësi kaq e ngushtë në mes prokurorit dhe avokatit a krijon parakushtet për paragjykim dhe favorizim?
- A ndërhyjnë kjo marrëdhënie në ushtrimin e funksioneve të prokurorit?
- Po perceptimi i tjerëve, palëve, kolegëve, publikut?
- Cili do të ishte qëndrimi i një vëzhguesi objektiv, të arsyeshëm, të jashtëm e të paimparesuar, që di për raportet e afërta të tyre, ka apo jo dyshime për paanshmëri nga prokurori.

Komentim:

Këtyre situatave prokurori duhet t'u shmanget. Ai përveç që duhet të jetë i paanshëm, duhet edhe të duket si i paanshëm. Kështu ai mund të krijojë perceptim negativ për paanshmëri. Edhe pse asnjë normë ligjore apo etike nuk kërkon që prokurorët duhet t'i shkëpusin të gjitha lidhjet dhe kontaktet me avokatë, të cilët mund të jenë miq, shokë shkolle, fqinj apo farefis, megjithatë, këto raporte duhet ndërtuar me shumë kujdes dhe transparencë. Shoqërimi i vazhdueshëm me të njëjtin avokat me të cilin ka edhe shumë raste, çdo vëzhgues objektiv mund ta shpie deri te perceptimi për mungesë integriteti dhe paanshmërie.

iii. Integriteti

Integriteti ka të bëjë me cilësinë e një personi që të jetë i ndershëm dhe të ketë parime të larta morale, të cilat nuk pranon t'i ndryshojë. Po ashtu, ka të bëjë me standarde të larta në kryerjen e punës me përkushtimin që të mos t'i ulë këto standarde.

Integriteti i një prokurori përfshin ruajtjen e qëndrueshmërisë, saktësisë në punë dhe besueshmërisë gjatë tërë punës së tij/saj si prokurorë, duke mos bërë asnjë veprim/mosveprim apo sjellje e cila e turpëron.

Prokurorët si zyrtarë të thirrur që të merren me zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të kryesve të veprave penale janë në rendin e parë të përfaqësuesve të shtetit, të cilët duhet të jenë të pajisur me cilësi të larta morale.

Këto cilësi nuk duhet të sillen në pyetje asnjëherë. Prokurori duhet të jetë dhe të shihet si person me integritet absolut.

Çdo shmangie nga standardet e larta të sjelljes personale dhe profesionale nga ana e një prokurori paraqet cenim të integritetit të tij.

Një prokuror që ka qëndrueshmëri në mes asaj që flet dhe asaj që vepron dhe nuk shmanget nga kjo asnjëherë konsiderohet person me integritet personal.

Prokurori duhet që fokusin ta vejë në përgjegjësitë që i kërkon pozita e prokurorit dhe jo në privilegjet e fuqinë që ajo i sjell.

Ai duhet ta shohë punën si mision, e jo si vend për sigurimin e privilegjeve, përparësive dhe marrjes së një page.

Integriteti është gjithmonë i lidhur ngushtë me besimin e publikut.

Prokurorët që nga marrja e detyrës duhet të bëjnë një jetë më të kufizuar që njerëzve të rëndomtë nuk iu ndodhë, për arsye se prokurorët, sikundër edhe gjyqtarët janë nën vëzhgimin e vazhdueshëm të publikut dhe mjeteve të informimit. Kjo vlen edhe për pjesën e jetës zyrtare, edhe për jetën personale.

Sjelljet publike të një prokurori duhet të jenë të atilla që i përgjigjen natyrës së punës së tij, sepse një sjellje e papranueshme nga ana e prokurorit sjell pasoja edhe për integritetin dhe dinjitetin e sistemit në tërësi dhe besimit të publikut në të.

Prokurori duhet të jetë i kujdesshëm lidhur me krijimin e lidhjeve të ngushta miqësore me palët dhe avokatët, të cilët kanë punë dhe përfaqësime zyrtare në prokurori.

Çdo prokuror duhet të sillet me kujdes të shtuar edhe në jetën private. Ai duhet të jetë i pajisur me cilësinë e integritetit, mirësjelljes, ndershmërisë edhe pasi t'i përfundojë orët e punës, në rrugë, në fqinjësi dhe në vendet, ku kalon kohën e lirë etj.

Në këtë mënyrë ai ruan dinjitetin e tij dhe dinjitetin e prokurorisë përkatëse, ruan dhe nxitë një imazh të mirë dhe besimin e publikut në punën e tërë sistemit.

Kontaktet shoqërore me avokatët dhe gjyqtarë janë të lejuara në parim dhe nuk përbëjnë vetvetiu problem, megjithatë, shoqërimi i tepruar mund të lind keqkuptime.

Kontaktet e tepërta me gjyqtarë, aty ku prokurori përfaqëson raste mund të vlerësohet nga palët se ka hyrë në komunikim të njëanshëm me gjyqtarin. Ndërsa, me avokatët, me të cilët e bashkon puna në raste të ndryshme duhet të bëhet më shumë kujdes për shkak se mund të dëmtojë imazhin e prokurorit dhe tërë sistemit, si dhe të krijojë perceptim negativ për paanshmërinë.

Ndërkaq, në rastet kur një prokurori-reje, bashkëshorti-ja i punojnë avokatët, edhe pse kjo nuk ndalohet, prokurori që ndodhet në këso rrethanash, duhet të bëjë kujdes maksimal në mënyrën se si duken në publik.

Sjelljet që krijojnë përshtypje se edhe prokurori po merret me punë avokatie do të ketë pasoja të mëdha për atë prokuror dhe për institucionin në tërësi. Veprimet elementare që duhet të ndërmarrin në këso rastesh janë mosshfrytëzimi i zyrës dhe telefonit të përbashkët.

Shembuj të sjelljeve, të cilat cenojnë integritetin e një prokurori janë:

- Dështimi që në mënyrë të kujdesshme dhe objektive t'i vlerësojë dhe t'i prezantojë të gjitha faktet e rëndësishme në gjykatë;
- Bërja e kritikave të papërshtatshme në publik
- Mosrespektimi i konfidencialitetit gjatë fazës së hetimeve;
- Përfshirja në çfarëdo forme në një aktivitet politik dhe shprehja e qëndrimeve, simpatie apo antipatie ndaj individëve apo grupeve të ndryshme;
- Hyrja në komunikime të papërshtatshme me gjyqtarët dhe avokatët;
- Shoqërimi me njerëz me reputacion të keq dhe me ata që merren me aktivitete të dyshimta;
- Frekuentimi i vendeve apo lokaleve të dyshimta;
- Mospranimi i përgjegjësive për veprime të pahijshme;
- Trajtimi pa respekt dhe joprofesional i stafit me të cilët punon;
- Mosmbajtja e premtimeve pa ndonjë arsye;
- Gënjeshtria;
- Mosrespektimi i detyrimeve financiare;
- Të qenit i prirë për sjellje manipuluese;
- Shfrytëzimi i dobësive të të tjerëve dhe kthimi i këtyre dobësive në favor të tij/saj;
- Përdorimi i statusit si prokuror për të përfituar një trajtim preferencial;
- Përdorimi i papërshtatshëm apo abuzimi i çfarëdo lloji i kolegëve/personelit administrativ, duke i detyruar ata që të kryejnë shërbime në favorin e tyre.²

Integriteti i një prokurori cenohet edhe me çdo sjellje tjetër që sjell në dyshim besimin e publikut në ndershmërinë, objektivitetin, përkushtimin, paanësinë dhe pavarësinë e tij. Ai me punën e tij, sjelljet dhe veprimet, nuk duhet të lë asnjë dilemë dhe mëdyshje te vrojtuesit objektivë, te ata që vendimet e tij i afektojnë dhe te ata me të cilët punon, se është i njëanshëm, se ka paragjykime ose është diskriminues, por që vendimet i merr në bazë të ligjit dhe me ndershmëri.

Shembulli 1: Një prokuror gjersa darkon në një restorant takohet rastësisht me një avokat me të cilin ka raste të shpeshta. Me avokatin njihen që nga studimet. Restoranti është plot me mysafirë. Avokati, i cili po ashtu kishte dalë për darkë ulet në të njëjtën tavolinë me të. Në fund avokati insiston dhe e paguan darkën.

Në këtë rast, dilemave që duhet përgjigjur janë:

- Cili është qëllimi prapa kësaj darke të paguar?
- A është korrupsion apo mirësjellje dhe respekt nga ana e avokatit?
- Si perceptohet kjo nga ana e të tjerëve?
- Si ndikon kjo te prokurori në vendimmarrjen e ardhshme?
- A e bën kjo që të ndihet si në borxh ndaj tij?
- Po nëse aty frekuentojnë shumë avokatë dhe kjo ndodhë shpesh?

² Vërejtje: Lista e situatave të përshkruara më lart nuk është shteruese.

- Si të veprohet në raste të tilla?

Komentim:

Prokurori duhet t'u shmanget këtyre situatave të krijuara, së paku, që cilësohen në dukje si mungesë integriteti dhe paanësie për të. Kjo dëmton në masë të madhe edhe besimin e njerëzve aty dhe publikut më të gjerë, për tërë sistemin e prokurorisë. Prokurori duhet që, gjithnjë, si gjatë punës së tij zyrtare, por edhe në jetën private, t'i ketë sjelljet e tij në harmoni me standardet e larta të etikës dhe sjelljes profesionale dhe të mos lejojë asnjë mëdyshje në ndershmërinë, sinqeritetin dhe paanshmërinë e tij.

Shembulli 2: Një prokuror e ka të caktuar një seancë shqyrtimi gjyqësor për një datë të caktuar. Rasti është i rëndë dhe i komplikuar. Janë pesë të akuzuar që ndodhen në Qendrën e Paraburgimit në Pejë dhe në Prizren. Dy të tjerë janë në arrest shtëpiak. Kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë. Gjykata ka lëshuar urdhëresat për sjelljen e tyre nga paraburgimi dhe, gjithashtu, ka dërguar ftesa për të akuzuarit që ndodhen në arrest shtëpiak, si dhe janë ftuar edhe dëshmitarët e rastit dhe eksperti i mjekësisë ligjore.

Natën, para gjykimit, prokurorit i vdes halla dhe e lajmërojnë se varrimi do të jetë po atë ditë.

- Si të veprojë prokurori?
- Të shkojë në varrimin e hallës ku janë mbledhur gjithë familja, të dështojë gjykimi për mungesë të tij dhe të kthehen mbrapa të akuzuarit, dëshmitarët dhe eksperti?
- Të shkojë në gjykimin e caktuar dhe të mbahet gjykimi?

Komentim:

Kjo është një dilemë, të cilën duhet ta zgjidhë vetë prokurori. Në raste të ngjashme duhet të vendosë në mes detyrimeve familjare, nevojave e kërkesave të palëve dhe gjithë pjesëmarrësve të tjerë në shqyrtim, të cilët duhet t'i ketë parasysh dhe t'i respektojë gjithnjë. Të mundohet të krijojë një balancim në mes këtyre dy kërkesave. Në rastin konkret, një prokuror i pajisur me cilësi të larta të integritetit, do të bëjë çmos që të mposhtë ndjenjat personale dhe dhimbjen, si dhe nuk do të lejojë dështimin e gjykimit.

Shembulli 3: Një prokuror ka blerë një veturë të markës BMW. Pas një defekti të vogël e dërgon veturën për riparim. Pas eliminimit të defektit, mekaniku duke e ditur se është prokuror nuk pranon t'ia marrë paratë. Pas një kohe, prokurori ka nevojë prapë ta dërgojë veturën te mekaniku. Në qytet është i vetmi lokal që merret me rregullimin e defekteve të veturave të markës BMW.

- Si të veprojë prokurori në këtë situatë?
- Të shkojë prapë te personi i njëjtë?
- Të mos shkojë më aty?
- A duhet domosdoshmëri të këmbëngulë që të bëjë pagesën?

- Të kërkojë ndonjë punëtori të automekanikut të ngjashëm në qytetet përreth ku do ta rregullojë veturën e tij?

Komentim:

Prokurori në këtë rast duhet të vejë në rend të parë integritetin e tij dhe dukjen se e posedon këtë cilësi, në sytë e tjerëve. Integriteti është qenësor për besimin e publikut në punën e tij dhe tërë sistemit. Shkuarja përsëri te mekaniku i njëjtë pas përvojës së parë nuk i bën nder një prokurori. Kjo tregon se e ka pranuar si të mirëqenë sjelljen e mekanikut dhe se është i gatshëm të hyjë sërish në këso raportesh. Gjithashtu, kjo sjellje përçon mesazhin e keq se në të ardhmen, po qe se paraqitet nevoja, mund t'ia kthejë këtë favor gjatë punës së tij, prandaj, medoemos, duhet evituar situata të tilla.

Shembull 4 - Prokurori L është njëkohësisht mësimdhënës në një universitet privat, ku jep një lëndë të caktuar. Ai rregullisht kërkon nga zyrtari ligjor i zyrës së tij që të shtype teste dhe materiale të tjera për nevojat e tij në punën me student, të fotokopjojë të bëjë telefonata dhe të kryejë shërbime të tjera.

- A ka të drejtë prokurori të ligjërojë në universitetin privat?
- A është veprimi i duhur i prokurorit, duke qenë se kjo është në shërbim të përcjelljes së dijes te gjeneratat e ardhshme?
- A ka të drejtë prokurori të shfrytëzojë resurset e prokurorisë për qëllime private?

Komentim:

Shfrytëzimi i resurseve të prokurorisë për qëllim private është në kundërshtim me Kodin e Etikës. Në të njëjtën kohë, prokurori ka të drejtë të ligjërojë në një universitet privat si punë dytësore, për aq sa një veprim i tillë nuk shfaq pengesë për kryerjen e detyrave të prokurorit. Prokurori nuk duhet të përdorë statusin si prokuror dhe reputacionin e prokurorisë për të avancuar të drejtat apo interesat e tij personale, si dhe nuk do të kryejë asnjë detyrë apo shërbim tjetër që mund të ndërhyjë në pavarësinë dhe paanshmërinë e tij apo që në ndonjë mënyrë tjetër mund të mos jetë në përputhje me ushtrimin e funksionit të prokurorit.

Shembulli 5 – Prokurori G nga prokuroria themelore ftohet nga Këshilli Prokurorial për të shkuar në një vizitë studimore dyjavore në Gjermani. Në ftesën e marrë nga Prokuroria e Gjermanisë, e cila iu ka përcjellë prokurorit nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës, thuhet në mënyrë eksplicite: “Prokuroria e Gjermanisë me rastin e kësaj vizite merr përsipër mbulimin e të gjitha shpenzimeve përveç atyre të transportit nga Kosova në Gjermani dhe anasjelltas. Prokurori shkon e kryen me sukses vizitën studimore në Gjermani, por pasi kthehet në vendin e tij të punës në Prokurorinë Themelore parashtron kërkesën për rimbursim të shpenzimeve të bëra në Gjermani. Prokurori do të pretendojë kompensimin e plotë të shpenzimeve në kërkesën e tij, duke përfshirë edhe ato që janë mbuluar nga Prokuroria e Gjermanisë.

Në këtë rast shtrohen këto pyetje:

- A mund të pretendojë prokurori në emër të shpenzimeve edhe atë kosto që është mbuluar nga Prokuroria e Gjermanisë?

Komentim:

Një veprim i tillë i prokurorit është në kundërshtim me Kodin e Etikës dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë. Prokurori mund të kërkojë kompensimin në emër të shpenzimeve të bëra vetëm për shpenzimet e transportit, të cilat nuk kanë qenë të mbuluara nga organizatori i vizitës studimore.

Shembulli 6: Pak kohë para festave, një avokat e sjell një tortë të madhe në zyrën e prokurorit, të cilën e dorëzon te asistentja e tij, me një kartë që përmban urimet për festat.

- Çfarë duhet të bëjë prokurori në këtë rast?
- Sa ka rëndësi se çfarë llojesh të dhuratave jepen?
- A ka rëndësi nëse dhurata iu ka dhënë një punëtori apo zyrtari, e jo prokurorit?

Komentim:

Nuk ka rëndësi se ç'loj i dhuratës është ofruar. Parimi themelor është që shoqëria duhet të ketë besim në integritetin dhe pavarësinë e prokurorit, si dhe te të gjithë prokurorët dhe personeli i saj. Dhuratat që i ofrohen prokurorëve apo personelit mund të interpretohen si të synuara apo të dhëna me qëllim përtej vetë dhuratës, si dhe mund të çojnë drejt konstatimit që veprimi i prokurorit do të ndikohet apo është ndikuar nga ajo dhuratë. Nuk ka dallim ndërmjet prokurorëve dhe personelit të prokurorisë sa i përket ndalesës së pranimit të dhuratave. Nuk ka fare rëndësi që dhurata i është dhënë personelit të prokurorisë, e jo prokurorit. Pranimi i dhuratës nga personeli i prokurorisë është po aq i ndaluar sa për prokuror. Në këtë rast prokurori duhet t'i kërkojë asistentes së tij që në asnjë formë të mos pranojë asnjë lloj dhurate.

Shembulli 7: Ndodhëni në një gjykim të një rasti mjaft të komplikuar ku zëvendësoni kolegun tuaj, i cili ndodhet në SHBA në shkollim për Master në drejtësi.

Kolegu i juaj, i cili e ka ngritur aktakuzën, ka akuzuar edhe për një vepër, cilësimi juridik i së cilës nuk i përgjigjet fare përshkrimit faktik dhe, gjithashtu, nuk mbështetet me prova. Në gjykim gjithë vërejtjet dhe kritikrat të drejtohen ty si prokuror, tani i ngarkuar me rast.

- Si duhet të veprojë prokurori?
- Të thoni se nuk është gabimi juaj, porse do të mundoheni ta korrigjoni?
- Të tregoni se kush e ka bërë atë gabim?
- T'u thoni se ju kurrë nuk do të kishit vepruar ashtu?
- Ta përmirësoni gabimin gjatë fjalës përfundimtare pa përmendur kolegun tuaj?

Komentim:

Prokurorët gjatë gjithë kohës duhet ta ruajnë nderin dhe dinjitetin e pozitës dhe profesionit të tyre, si dhe të gjithë sistemit të prokurorisë. Çdo prokuror duhet të marrë përgjegjësinë e secilit rast me të cilin merret dhe e përfaqëson. Ai duhet të jetë personalisht përgjegjës për secilin rast që e përfaqëson në gjykim. Ai duhet ta pranojë përgjegjësinë për çdo lëshim apo mangësi të rastit. Asnjëherë nuk duhet që publikisht ta drejtojë gishtin në drejtim të kolegëve të vet dhe të mundohet t'ia hedh fajin tjerëve.

Shembulli 8: Prokurori X tenton që ta bindë të akuzuarin për ta pranuar fajësinë për një vjedhje të rëndë në shtëpinë e një të dëmtuari, me ç'rast ka marrë sende në vlerë të konsiderueshme. Prokurori edhe pse bën përpjekje, nuk arrin ta bindë të akuzuarin që ta pranojë fajësinë. Gjatë gjyqimit, i akuzuari para gjykatësve dhe pjesëmarrësve të tjerë tregon se prokurori i ka thënë se duhet ta pranojë fajësinë për këtë vepër.

- Çka ka të papranueshme në sjelljen e prokurorit?
- Cila është detyra e prokurorit në raste të tilla?
- A i lejohet të insistojë në pranimin e fajësisë?
- Çka nëse pranimi i fajësisë nuk mbështetet me prova të sigurta?

Komentim:

Një prokuror i drejtë, i pavarur dhe me integritet të pakontestueshëm, asnjëherë nuk do ta shtyjë të akuzuarin në pranimin e fajësisë dhe as në hyrjen në marrëveshje për pranim fajësie. Me përjashtim të njoftimit për të drejtat e parapara me ligj, prokurori duhet të përmbahet nga dhënia e këshillave ligjore të akuzuarit. Asnjëherë nuk duhet t'i premtojë diçka të akuzuarit. Të mos i rekomandojë, po ashtu, asnjëherë avokatin e caktuar. Prokurori duhet t'i shmangë gjithnjë bisedat private me një të akuzuar.

iv. Konfidencialiteti

Konfidencialiteti paraqet mbrojtjen e informatave gjatë kryerjes së detyrës si prokuror. Prokurori duhet të jetë i kujdesshëm me dhënien e informatave në fazën e hetimeve, por edhe në fazat e tjera të procedurës.

Gjersa përcjellja e informatave, mjeteve të informimit, por edhe personave të tretë, gjatë hetimeve duhet të jetë tejet i kufizuar dhe mund të transmetohet vetëm atëherë sa nuk e dëmton hetimin.

Në raport me palët në proces dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, prokurori duhet t'i informojë ata në përputhje me detyrimet ligjore, me fazën e procedimeve penale dhe planet që janë në vijim të hetimit.

Prokurorët duhet të bëjnë kujdes që të mos prononcohen për media pa leje dhe pa konsultim me eprorin e tyre dhe të përkujdesen që interesimit të mediave kryesisht t'u përgjigjen prokurorët e caktuar për komunikim publik, zyra për komunikim publik, përkatësisht, zyrtarët për media të punësuar nëpër zyrat e posaçme.

Asnjë prokuror nuk guxon të favorizojë dhe të privilegjojë një ose vetëm disa media dhe të krijojë raporte të afërta, duke i pajisur ata me informacione të cilat mediat e tjera nuk kanë qasje.

Prokurori mund të ketë sulme nga mediat për shkak të pozitës që ka dhe për shkak se vendimet e tij prekin interesat e personave të ndryshëm. Në këto raste prokurori duhet të përmbahet dhe të mos përgjigjet ndaj sulmeve të mediave, përveç në rastet kur vlerësohet nga eprori.

Duke hyrë në debate dhe polemika me mjetet e informimit, prokurori shkelë paanësinë, së paku në dukje dhe kështu bën shkelje të kodit të etikës.

Një prokuror i mirë dhe me integritet flet kryesisht përmes vendimeve të veta, përmes akteve të ndryshme, mjeteve juridike dhe jo të kundërvihet përmes mediave.

Nëse një prokuror del në media dhe në emër të prokurorisë deklarohet, atëherë nuk duhet të flasë për rastet konkrete, përveç kur autorizohet nga eprori, sidomos jo për ato që janë në hetime, por vetëm në aspektin teknik, për sfidat e sistemit të drejtësisë, standardet e profesionalizmit, funksionimin e sistemit dhe mangësitë e tij, si dhe të ngjashme.

Gjithashtu, prokurorët duhet të jenë tejet të kujdesshëm që të dhënat personale të personave, të cilët janë të përfshirë në proces në çfarëdo cilësie të mos publikohen në asnjë mënyrë, me përjashtim të rasteve dhe të rrethanave kur lejohet me ligj.

Shembull 1 - Prokurori A është shok fëmijërie me personin B, i cili është pronar i një kompanie mediale ndër më të mëdhatë në vend. Gazeta e tij ia kushton një hapësirë të madhe zhvillimeve aktuale në drejtësi dhe rasteve që janë duke u trajtuar. Prokurori A është burim i pashtershëm i informatave për këtë gazetë. Ai i jep informata për rastet në vijim që ende nuk kanë përfunduar. Këto informata i boton rregullisht gazeta, pa cituar burimin e informatës. Ndërkohë, herë pas here, kjo gazetë flet në mënyrë pozitive për këtë prokuror, duke e lëvdur për punën e tij. Me kalimin e kohës, komuniteti i prokurorëve fillon të dyshojë se pikërisht prokurori A, në mënyrë anonime është duke e pajisur gazetën me këto informata.

- A është ky veprim i prokurorit në kundërshtim me Kodin e etikës për prokurorë?
- A guxon prokurori që të nxjerrë informata për rastet që janë në procedurë në rrethet e tij miqësore?

- Si duhet të veprojë prokurori në situatën kur gazetarin e ka mik të mirë dhe puna e tij varet shumë nga këto informata?

Komentim:

Prokurorët duhet të ruajnë fshehtësinë e informatave në lidhje me hetimet në zhvillim e sipër dhe gjykimet të cilat gjykata në harmoni me ligjin i ka shpallë si të mbyllura për publikun. Në këtë mënyrë mund të sillen në rrezik jeta dhe siguria e të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe qytetarëve të tjerë, të cilët janë pjesëmarrës në procedurë. Prokurorët nuk guxojnë që informatat që i posedojnë t'i përdorin për sigurimin e favoreve për vete apo tjetrin. Nëse një prokuror ka një mik gazetar, ai duhet të përmbahet maksimalisht në dhënien e informatave nga rastet në procedim. Këto informata duhet të komunikohen vetëm nga zyrtarët për informim, prokurorët e caktuar për informim dhe eventualisht eprori i asaj prokurorie, ose vetë prokurori i rastit me autorizimin e kryeprokurorit.

Shembull 2 - Një gjyqtar publikisht përmes mediave kritikon prokurorin e një prokurorie se është i paafte të menaxhojë rastet e veta, se në zyrën e tij nuk ka rregull dhe askush nuk e respekton askënd, përfshirë edhe atë si prokurorë. Pas kësaj deklarate disa media, përfshirë edhe atë media që e ka marrë në intervistë gjyqtarin, e ftojnë prokurorin për një intervistë televizive. Prokurori pranon, pa marrë lejen paraprakisht nga eprori i tij, pa u konsultuar me ndonjërin dhe në këtë intervistë ia kthen sulmet gjyqtarit, duke u shprehur me fjalë të papranueshme dhe joprofesionale për gjyqtarin.

- Si është dashur të veprojë prokurori?
- A është sjellja e tij në pajtim me Kodin e etikës?
- Si t'ju përgjigjet prokurori akuzave publike të gjyqtarit?
- A iu lejohet prokurorëve të sillen ashtu që të dëmtojnë imazhin dhe dinjitetin e institucionit?

Komentim:

Në këso lloj situatash, prokurori duhet të përmbahet dhe të mos fillojë debatin apo polemikat me gjyqtarin. Komunikimet e tilla mund të mos përfundojnë asnjëherë dhe kështu mund të krijohet përshtypja në publik për “luftëtarë arenash”, që në vend që të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara me ligj e kushtetutë, merren më tepër me çështje të ngushta personale. Prokurori duhet të flasë gjithmonë me punën e tij, me aktet procedurale të shkruara, me mjetet ligjore juridike, me paraqitje dinjitoze në shqyrtim në emër të shtetit, në shërbim të të cilit është dhe me sjellje që nuk lënë asnjë vend për qortim nga çdo vëzhgues i paanshëm.

Shembulli 3 - Një prokuror në një debat televiziv me emocione dhe me zë të lartë ka kritikuar institucionet gjyqësore dhe gjykatësit në përgjithësi. Në mes të tjerave, ai thekson se gjyqtarët janë joprofesionistë, dembelë ose janë të korruptuar, sepse, sipas tij, nuk ka logjikë të shëndoshë

që gjyqtarët në shumicën e rasteve i lirojnë figurat e larta publike për vepra penale kundër detyrës zyrtare, ku kryesisht hyjnë veprat penale të korrupsionit.

- A është veprimi i prokurorit brenda kuadrit të lejuar të sjelljes të përkufizuar me Kodin e etikës?
- A hyn kjo deklaratë brenda të drejtës fundamentale të çdo njeriu për ushtrimin e të drejtës në shprehjen e lirë të mendimeve?
- A ka diçka të palejuar në sjelljen dhe fjalët e prokurorit?

Komentim:

Sjellja e prokurorit në këtë rast është e papranueshme dhe mund të paraqesë shkelje të Kodit të etikës. Prokurori nuk guxon të bëjë kritika të papërshtatshme për gjykatat, gjyqtarët dhe punën e tyre. Në vend të saj, prokurori duhet t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet e rregullta juridike dhe të jashtëzakonshme, të cilat i ka në dispozicion. Prokurori mund të paraqitet në debate me autorizim të eprorit për të prezantuar rezultatet e sistemit prokurorial, por nuk është etike të bëjë deklaratime të papërshtatshme për sistemin gjyqësor.

Shembulli 1: Prokurori M ndodhet në pushim mjekësor. Rastësisht, në zyrën e burimeve njerëzore, prokurorit X i bie në dorë një raport i mjekut së bashku me diagnozën e prokurorit M. Sipas këtij raporti, arsye e pushimit mjekësor është një kontroll mjekësor jashtë vendit. E gjitha kjo për shkak se prokurori M është diagnostikuar me HIV-pozitiv. Me të kuptuar këtë, prokurori X ndien keqardhje për kolegun për shkak të diagnozës dhe po këtë çështje e bisedon me një koleg tjetër prokuror.

- Si do të duhej të vepronte prokurori X me këtë rast?
- T'i tregojë kolegut se çfarë ka parë dhe të diskutojë me të?
- Të bisedojë me eprorin e tij?
- Të heshtë dhe të mos flasë me askënd?

Komentim:

Një prokuror i ndershëm dhe me integritet nuk do të zbulojë asnjëherë informata të çfarëdo natyre qofshin ato, e, sidomos, ato të natyrës personale për kolegët e vet. Në rastin konkret, prokurori X është dashur ta ruajë vetëm për vete informatën për kolegun M dhe të mos ta ndajë me kolegë të tjerë. Me veprimin e tij, prokurori X ka cenuar fshehtësinë e informacionit të mbrojtur personal dhe ka dëmtuar integritetin dhe dinjitetin e prokurorit M.

Shembulli 2: Një ish-aktore e famshme është privuar nga jeta. Rasti iu ka dhënë juve për ta trajtuar, sepse në kohën e vrasjes keni qenë kujdestar dhe keni dalë në vendin e ngjarjes. Gjatë

punës keni ardhur deri te shumë informacione të ndjeshme lidhur me të ndjerën. Në dosjen e rastit keni edhe dokumente dhe fotografi që flasin për situata dhe rrethana shumë të pakëndshme dhe të panjohura lidhur me të ndjerën, e cila ishte e njohur dhe e adhuruar nga masa e gjerë. Një koleg i juaj, nga kureshtja shpreh dëshirën që t’i shikojë fotografitë dhe dokumentacionin tjetër në dosje.

- Si do të veproni?
- Do t’ia tregoni materialet?
- Do t’i tregoni, por do t’ia tërhiqni vërejtjen që të mos flasë?
- Nuk do t’i tregoni fare, por do ta ruani fshehtësinë e informatave private të siguruara gjatë punës tuaj?

Komentim:

Privatësia dhe dinjteti i viktimave duhet të ruhet me vigjilencë dhe zell të shtuar. Prokurorët nuk duhet t’i diskutojnë asnjëherë me të tjerët për rastet e tyre. Prokurori duhet t’i trajtojë me shumë konfidencialitet dhe të mos i ndajë me personat e tjerë bisedat, diskutimet dhe dokumentacionin e siguruar në një rast të caktuar.

v. Llogaridhënia dhe transparenca

Llogaridhënia dhe transparenca janë pjesë e parimeve bazë, të cilat e karakterizojnë punën e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Llogaridhënia dhe transparenca, si vlera thelbësore dhe zbatimi i tyre, janë të sqaruara më gjerësisht në Kodin e etikës. Që të dyja bashkë përbëjnë elemente bazë për zhvillimin dhe funksionimin efikas të Prokurorit të Shtetit në kuadër të komunikimit publik, paraqitjes para publikut dhe para palëve në procedurë, duke i respektuar legjislacionin dhe kodin e etikës, të cilat i përcaktojnë qartë sjelljet e prokurorëve në kuadër të llogaridhënies dhe transparencës.

Transparenca e prokurorit ka të bëjë me të qenit i hapur dhe i sinqertë në shpjegimin e të gjitha veprimeve të tij në rastet konkrete dhe njoftimin e publikut të gjerë me ato raste, për aq sa nuk dëmton një hetim apo një procedurë në një fazë tjetër.

Këtë prokurori e përmbushë fillimisht duke i njoftuar palët për veprimet e veta, duke i pajisur me shkresa dhe duke njoftuar për zhvillimet gjatë rrjedhës së procedurës, ashtu siç parashihet me ligj.

Prokurori duhet të përmbahet nga cilido kontakt me publikun pa pëlqimin apo autorizimin e kërkuar.

Llogaridhënia e prokurorit në punë paraqet përgjegjësinë për të kryer detyrat për të cilat është kompetent, t'i përmbushë detyrimet që kërkohen me kushtetutë dhe ligj, të respektojë orarin e punës, të jetë me kohë në seanca dëgjimore në gjykatë gjatë përfaqësimit të rasteve dhe në përgjithësi të jetë i saktë, efikas dhe i përgjegjshëm.

Llogaridhënia ka të bëjë me cilësinë dhe gatishmërinë e prokurorit që të japë llogari dhe të jetë i gatshëm të pranojë përgjegjësitë e tij për veprimet dhe mosveprimet, si dhe për gabimet eventuale gjatë punës së tij.

Shembulli 1: Në një qytet ka pasur të shtëna me armë. Si rezultat i këtyre të shtënave katër persona kanë humbur jetën. Ky është rasti i parë që ka ndodhur në këtë qytet, ku një numër kaq i lartë i personave kanë humbur jetën. Banorët e qytetit janë të tronditur dhe duan informacione sa më të shpejta lidhur me rastin.

- Çfarë mjetesh komunikimi duhet të përdorë prokurori për të dhënë sqarime?
- Çfarë informatash duhet prokurori t'iu japë mediave?
- Sa i hapur duhet të jetë prokurori me mediat dhe publikun?

Komentim:

Në raste të tilla, prokurori në koordinim me eprorin, duhet ta njoftojë opinionin lidhur me rastin, por gjithmonë informatat nuk duhet të dëmtojnë procesin e hetimeve apo të paragjykojnë rastin. Hezitimi i prokurorit për të dalë para opinionit mund të shkaktojë shqetësim te qytetarët, keqkuptime, frikë dhe panik, në mënyrë që të parandalohen dezinformatat lidhur me rastin.

Shembulli 2: Në media qarkullojnë lajme se prokurori Y s'e ka deklaruar tërë pasurinë e tij sipas normave ligjore në fuqi. Prokurori Y, i shqetësuar me këtë lajm dhe i bindur se i ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore për deklarimin e pasurisë, e ndien nevojën që t'ia sqarojë opinionit të vërtetën.

- Çfarë duhet të bëjë prokurori?
- A duhet të komunikojë me mediat?
- Përmes kujt duhet të komunikojë me mediat?

Komentim:

Në rastet e tilla, prokurori në konsultim me eprorin mund të japë sqarime për opinionin lidhur me çështjet e ngritura në media.

vi. Profesionalizmi

Vlera tjetër thelbësore dhe shumë e rëndësishme e Kodit të etikës është profesionalizmi. Prokurorët kanë shumë hapësirë që ta përdorin diskrecionin e tyre në raste konkrete. Megjithatë, kjo liri profesionale përfshinë edhe detyrën për ta përdorur këtë diskrecion në mënyrë të përgjegjshme.

Njohuritë dhe ekspertiza për kryerjen e detyrave duhet të jenë adekuate me punën e tij dhe duhet të bëjë përpjekje që këto njohuri në vazhdimësi t'i zhvillojë dhe avancojë. Këtë duhet ta bëjë përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe formave të ndryshme të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Prokurori duhet të ketë parasysh faktin se vendimet dhe veprimet e tij ligjore mund të cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, për këtë arsye duhet t'i zhvillojë shkathtësitë e tij profesionale.

Prokurori duhet t'i përcaktojë qëndrimet e tij shpejt, qartë dhe me profesionalizëm, në veçanti me palët në procedurë. Në raport me policinë, prokurori duhet t'i japë udhëzime në mënyrë të saktë dhe të qartë dhe në përputhje me legjislacionin.

Prokurori duhet të jetë gjithmonë i gatshëm t'i zëvendësojë kolegët që kanë arsye për mungesën e tyre. Ai organizon punën e tij në mënyrë të tillë që t'ia mundësojë një kolegu ta marrë përsipër një çështje pa shumë probleme, që nënkupton se ai/ajo do të njoftojë kolegun/en në kohë të arsyeshme për rastin.

Shembull 1: Noddheni në një shqyrtim gjyqësor për mashtrim dhe mbrojtësi është duke e marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë dëshmitarin tuaj. Gjatë marrjes në pyetje, mbrojtësi i bën pyetje të rënda, të papranueshme, kapricioze, duke e ironizuar shpesh me pyetje dhe duke i bërë aq shumë pyetje sa që nuk i jep hapësirë për t'u përgjigjur. Në përgjithësi sillet shumë keq me të.

- Si duhet të veprojë prokurori në këso rastesh?
- Të heshtë dhe të pretë të përfundojë marrja në pyetje?
- T'ia lërë në dorë të gjitha gjykatës?
- Të presë që me anë të rimarrjes në pyetje nga ana e tij t'i korigjojë dëmet, të cilat i ka bërë mbrojtësi?
- T'i bëjë vërejtje gjykatës dhe ta ndalojë atë formë të marrjes në pyetje?

Komentim:

Çdo prokuror ka për detyrë ta mbrojë dëshmitarin e vet, duke bërë vërejtje në çdo rast të marrjes së tillë në pyetje. Nuk duhet të lejojë asnjëherë që dikush të sillet në mënyrë abuzive me dëshmitarin e prokurorisë. Duke drejtuar vërejtje te trupi gjykues, në mënyrë që ta ndalojë marrjen e tillë në pyetje dhe sjelljen abuzive me dëshmitarin.

Shembulli 2: Prokurori N ka në punë një rast, i cili tani është në fazën e gjykimit. Mbrojtësi posedon provat që i ka edhe prokurori. Një dëshmitar i prokurorisë e ndryshon deklaratën rrënjësisht, mirëpo mbrojtësi është i pavëmendshëm, nuk e vëren dhe nuk e thekson gjatë marrjes në pyetje nga ana e tij.

- Si do të veproni ju?
- A do ta zbuloni si prokuror dhe ta dëmtoni rastin tuaj?
- A do të heshtni me shpresën se as gjykata nuk e ka vënë re?
- Do të flisni vetë dhe do ta vëni në dyshim dëshmitarin tuaj dhe me këtë do ta dobësoni edhe rastin?

Komentim:

Kur prokurori prezanton një rast në emër të shtetit, ai këtë duhet ta bëjë me ndershmëri dhe profesionalizëm të lartë. Prokurori nuk duhet të kërkojë që me çdo kusht të nxjerrë një vendim dënues për të pandehurin. Në vend të kësaj, prokurori duhet që të sigurohet se të gjitha provat e rëndësishme të jenë të prezantuara para gjykatës, si ato që shkojnë në dëm, po ashtu edhe ato që janë në favor të të pandehurit.